



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data <u>24.01.2023</u>	Vendi <u>KAÇANIK</u>
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	<u>104/02-2173 -1.</u>	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

Procesverbal nga Takimi Publik me temë : Puna e Kryetarit të arriturat dhe sfidat gjatë vitit 2022

Data 19.12.2022

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal  
Ora:14:00

Takimin fillimisht e hapi Kryetari i Komunës Besim Ilazi, ndërsa prezantuan edhe stafi i ekzekutivit dhe Nënkyetari Sabedin Vishi.

Kryetari Ilazi tha se duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ ( MAPL ) Nr.06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Komuna e Kaçanikut ka organizuar këtë takim publik.

Fillimisht Kryetari përvendetet qytetarët dhe përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave, duke i uruar ata përmarrjen e mandatit të ri. Në këtë takim kryetari prezantoi punët dhe aktivitetet komunale në secilin sektor gjatë vitit 2022. Viti 2023 do të jetë viti i pestë që nuk kemi asnjë investim nga institucionet qendrore, të bazuara në kërkesat e dorëzuara tash e sa vite, të cilat kanë mbetur në sirtarët e ministrive. Aktivitetet komunale kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2022, të bazuara në buxhetin komunal. Afér 600 mijë euro janë investuar në rrugë, kanalizim, trotuare e ndriçim publik, urbanizëm etj, ndërsa në sektorin e bujqësisë 392 fermer kanë përfituar nga subvencionet komunale. Administrata Komunale ka vazhduar punën e saj në përbushjen e kërkesave ndaj qytetarëve, kurse në turizëm jemi afér finalizimit të projektit të Hartave Turistike, ku tashmë edhe komuna jonë do të ketë një hartë orientuese për të gjithë vizitorët e saj, ku janë të përfshira edhe broshurat si dhe hartat digitale.

Një punë e jashtëzakonshme është bërë edhe në fushën e arsimit, ku janë rinashtuar shkolla, si dhe janë bërë investime në infrastrukturën shkollore. Në shëndetësi është në fazën përfundimtare ndërtimi i objekteve shëndetësore në Doganaj si dhe investime të tjera në infrastrukturën shëndetësore e sociale. Në fushën e kulturës përmes subvencioneve janë mbështetur shumë OJQ, Klube Sportive e Shoqëri Kulturore Artistike, ndërsa Muzeu i Qytetit po jetësohet.

Komentet:

Fahredin Dema, Nexhmedin Dema- banor të rrugës “ Qamil Ilazi”:

Shprehën shqetësimin e tyre në mos hartimin dhe përfundimin e procedurave të Planit Komunal Zhvillimor si dhe largimin e mbeturinave nga rruga.

Kryetari Ilazi i njoftoi se jemi në proces të fundit të hartimit të këtij plani, dhe sapo të përfundojnë detajet e fundit i njëjtë do të përcillet në Ministri, për të vazhduar më pas me procedurat e tjera siç janë debatet publike e deri tek jetësimi i dokumentit në fjalë.

Ramadan Kuka- Si qëndron Komuna e Kaçanikut me nivelin e cilësisë në arsim?

Kryetari Ilazi njoftoi se çdo ditë është duke u bërë punë e pa ndalur në krijimin e kushteve sa më cilësorë përmes mësim dhënie dhe mësim nxënje, si parakushte për ngritje të cilësisë në arsim, ndërsa përmendi edhe subvencionimin e transportit për nxënësit e shkollës profesionale.

Azem Koraqi- Kovaqec

Disa punë të mira janë kryer, ndërsa do të marrim kërkesat dhe nevojat e banorëve të këtij lokaliteti dhe të njëjtat do ti përcjellim tek komuna për trajtim të mëtejmë.

Fatmir Luta- Ivajë- Mbetet shqetësuese hedhja e mbeturinave ilegale në rrugën “ 24 Marsi”, prioritet me u hap rruga primare.

Brahim Dalloshi- Kërkoj që të pastrohen bazenet e ujit të pijes, caktimi i lokacionit për varrezat e fshatit si dhe rregullimi i disa rrugicave.

Adnan Krasniqi- Kaçanik i vjetër

Në lagjen “ Qardak” të rregullohen ujërat atmosferike, rregullimi i ndriçimit në rrugën “ Epopeja e UCK-së, di dhe vendosja e kapakëve të pushtave në disa rrugë.

Fadil Vishi- Dubravë

Kërkoj irregullimin e sistemit të ngrohës në shkollë, irregullimin e një përroske në fshat, irregullimin e një ure të vogël. Si dhe renovimin e fushës sportive në shkollë. Poashtu kërkoj ngritje të bashkëpunimit mes menaxherëve të projekteve dhe administratorëve.

Kryetari dhe stafi ekzekutiv poashtu u përgjigjën edhe në këto kërkesa, duke shtuar se të gjitha problemet do të trajtohen dhe diskutohen nga stafi komunal.